Komunikata

18/03/2026

Raporti I Ngjarjeve, 18 Mars 2026

Shkodër/Finalizohet operacioni i koduar "Wanted 2".

Kapet dhe ndalohet 1 shtetas në kërkim, i dënuar me 4 vjet e 8 muaj burgim.
I ndaluari, gjeshtar i një grupi kriminal që ka shitur lëndë narkotike, në Shkodër, i cili u godit nga Policia, gjatë operacionit të koduar "Buna 2021".

Në vijim të kontrolleve të kryera bazuar në informacionet e sigurueara në rrugë operative, për lokalizimin dhe kapjen e shtetasve të shpallur në kërkim, specialistët e Seksionit për Hetimin e Narkotikëve, në bashkëpunim me shërbimet e Komisariatit të Policisë Shkodër, kanë organizuar dhe finalizuar operacionin policor të koduar "Wanted 2", si rezultat i të cilit u kap dhe u vu në pranga shtetasi në kërkim:

-E. H., 48 vjeç, banues në Shkodër.

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër e ka dënuar këtë shtetas, me 4 vjet e 8 muaj burgim, për veprën penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", kryer në bashkëpunim.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, për veprime të mëtejshme.

Tiranë

Finalizohet operacioni policor i koduar "Flash", si rezultat i administrimit të shpejtë të informacioneve të sigurueara për një rast të shitjes së lëndëve narkotike.

Kapet në flagrancë dhe vihet në pranga 37-vjeçari që shiste lëndë narkotike Kokainë dhe Heroinë.

Sekuestrohen sasi të lëndëve narkotike Heroinë dhe Kokainë, të ndara në doza, gati për shitje, të cilat iu gjetën 37-vjeçarit, gjatë kontrollit fizik.

Seksioni për Hetimin e Narkotikëve, bazuar dhe në informacionet e sigurueara në rrugë operative, për një rast të shitjes së lëndëve narkotike, ka organizuar dhe finalizuar në bashkëpunim me shërbimet e Forcës së Posaçme "Shqiponja", operacionin policor të koduar "Flash".
Gjatë operacionit, u kap në flagrancë në Rrugën e Dibrës dhe u arrestua shtetasi:

-S. A., 37 vjeç, banues në Tiranë.

Gatë kontrollit, shërbimet e Policisë i gjetën shtetasit S. A., sasi të lëndëve të dyshuara narkotike Kokainë dhe Heroinë, të ndara në doza, gati për shitje.
Ky shtetas dyshohet se siguronte lëndë narkotike dhe i ndante në doza, të cilat i shiste në zona të ndryshme, kryesisht në Rrugën e Dibrës.

Vijojnë hetimet për dokumentimin e kësaj veprimtarie kriminale.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për veprime të mëtejshme.

Drejtoria Vendore e Policisë Korçë

Specialistët e Seksionit për Hetimin e Narkotikëve referuan materialet në Prokurori, ku filloi procedimi penal për shtetasin E. F., 37 vjeç, banues në Bilisht, pasi në qytetin e Bilishtit, gjatë kontrollit fizik, u gjet një sasi e vogël lëndë e dyshuar narkotike Kokainë.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Pogradec referuan materialet në Prokurori, ku filloi procedimi penal për shtetasin A. M., 57 vjeç, pasi u konstatua duke kryer punime ndërtimi, pa leje.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Devoll referuan materialet në Prokurori, ku filloi procedimi penal për shtetasit:
-Th. Z., 63 vjeç, banues në fshatin Dobranj, Devoll, pasi dyshohet se ka dëmtuar disa pemë frutore në tokën në pronësi të shtetasit F. Z.;
-P. K., 19 vjeç, banues në fshatin Hoçisht, Devoll, pasi në aksin rrugor "Bilisht-Miras", gjatë kontrollit në automjetin që ai drejtonte, u gjet një shkop bejsbolli, i cili u sekuestrua në cilësinë e provës materiale.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Maliq referuan materialet në Prokurori, ku filloi procedimi penal për shtetasen K. Y., 22 vjeç, banuese në Bilisht, Devoll, pasi në qytetin e Maliqit, dyshohet se ka qëlluar me shpatullë një 16-vjeçare, për motive të dobëta.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Korçës, për veprime të mëtejshme.

Korçë/Informacion paraprak

Më datë 18.03.2026, rreth orës 13:30, në aksin rrugor "Korçë-Maliq", pranë fshatit Lumalas, Korçë, autorësi me drejtues shtetasin K. G., është përplasur me automjetin me drejtues shtetasin K. Ç., i cili për pasojë, është lënduar dhe u dërgua për njëkohë në spitalin e Korçës.

Me drejtuesin tjetër, shtetasin K. G., po kryhen veprimet e mëtejshme procedurale.

Grupi hetimor po punon për sqarimin e rrethanave dhe përcaktimin e shkakut të aksidentit.

Drejtoria Vendore e Policisë Vlorë

Specialistët e Seksionit të Trafikut Urban dhe Interurban referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin A. B., 31 vjeç, banues në Durrës, pasi automjeti që drejtonte, është përplasur me automjetin që drejtonte shtetasi E. I.. Si pasojë janë dëmtuar shtetasi E. I. dhe një pasagjer në automjetin që drejtonte ai, të cilët kanë marrë asistencën mjekësore të nevojshme dhe janë larguar në banesa.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Vlorë referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për:
-shtetasin F. K., 49 vjeç, banues në fshatin Kaninë, pasi dyshohet se ka dëmtuar një objekt që shërbentë për vadhje;
-një 17-vjeçar, pasi dyshohet për motive të dobëta, ka goditur me grushte, një shtetas.

Specialistët e Stacionit të Policisë Selenicë referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin O. H., pasi dyshohet se me vetëgjyqësi, ka ndërtuar një njësi sipërfaqe toke në pronësi të një shtetasi tjetër.

Specialistët e Seksionit për Hetimin e Krimeve Ekonomiko-Financiare të Komisariatit të Policisë Sarandë referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasit:
-D. L., banuese në Sarandë, pasi dyshohet se ka falsifikuar dokumente, për të marrë pronësinë mbi një sipërfaqe toke;
-O. P, 39 vjeç, banues në Sarandë, pasi dyshohet se ka shqetësuar nëpërmjet thirrjeve/mesazheve telefonike, 2 shtetase;
-A. M., 18 vjeç, banues në Sarandë, pasi dyshohet se për motive të dobëta, ka goditur me grushte dhe me sende të forta, një 21-vjeçar.

Materialet procedurale iu referuan prokurorive kompetente, për veprime të mëtejshme.

Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë

Specialistët për Hetimin e Trafiqeve referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasen e huaj, D. M., pasi dyshohet se ushtronte prostitucion, në një apartament të marrë me qira.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 1:
-referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin E. D., për veprën "Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik";
-shpallën në kërkim shtetasin J. S., pasi dyshohet se për motive të dobëta, ka goditur me grushtë, shtetasin M. M. Punohet për kapjen e shtetasit J. S.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 2 referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin M. B., pasi dyshohet se ka kanosur ish-bashkëjetuesen e tij.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 3 referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për një të mitur, pasi dyshohet se për motive të dobëta, është konfliktuar me një të mitur.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 4:
-arrestuan shtetasen K. Z., 40 vjeçe, pasi dyshohet se ka vjedhur shiron ditore të subjektit ku punonte;
-referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasit E. B. dhe B. C., pasi dyshohet se kanë falsifikuar një dokument (prokurë), për hyrjen në Republikën e Shqipërisë, të shtetasit E. B., me autorësi;
-shpallën në kërkim shtetasin T. H., pasi dyshohet se në bashkëpunim me një shtetas tjetër, ende të paidentifikuar, kanë goditur me grushte, shtetasin A. Gj., të cilit gjithashtu i kanë vjedhur një shumë parash dhe 2 celularë. Punohet për veprën pëprava gërgëgjëisisë penale, të autorëve të rastit, si dhe për sqarimin e rrethanave.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 5 referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin P. K., për veprën "Mosbindja ndaj urdhrit të punonjësit të policisë së rendit publik".

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 7 arrestuan shtetasit:
-A. D., 33 vjeç, pasi dyshohet se ka ushtruar dhunë ndaj bashkëjetueses së tij;
-E. S., 39 vjeç, pasi dyshohet se ka ushtruar dhunë ndaj bashkëshortes së tij.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Krujë, gjatë kontrollit të kryer në banesën e shtetasit të shpallur në kërkim, Y. Z., gjetën në oborr, një sasi municioni luftarak dhe 14 fitila zjarrpërcjellës. Sendet e kundërligjshme u sekuestruan me cilësinë e provës materiale, ndërkaq, vijon puna për kapjen e shtetasit Y. Z.

Specialistët e qarkullimit rugor:
-bënë arrestimin në flagrancë të shtetasit A. B., 52 vjeç, pasi dje, mjeti që drejtonte është përfshirë në një aksident rrugor, me pasojë vdekjen e shtetases A. B., 72 vjeçe, e cila lëvizte me motorsipet elektrik;
-referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin L. P., pasi dyshohet se me automjetin që e drejtonte në efektin e alkoolit, ka përplasur 2 automjete. Nga aksidenti pati vetëm dëme materiale;
-referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin A. B., pasi automjeti që drejtonte, është përplasur me automjetin që drejtonte shtetasja E. Sh., e cila është në kujdesin e mjekëve dhe jashtë rrezikut për jetën.

Më datë 17.03.2026:
-kallëzoi shtetasja F. H., se nga ambientet e qendrës ku punonte, ishin larguar 3 te mitur, të huaj. Punohet për gjetjen e tyre;
-kallëzoi shtetasja M. A., se i kishin vjedhur automjetin të cilin e kishte lënë të ndezur, në rrugën "Lord Bajron". Punohet për identifikimin dhe kapjen e autorit/ëve të vjedhjes;
-deklaroi shtetasja M. M., se kishte paqartësi në lidhje me shkakun e humbjes e jetës së vëllait të saj shtetasit P. M., në Itali, 1 javë më parë. Materialet iu referuan për vlerësim Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Tiranës, për veprime të mëtejshme.

Drejtoria Vendore e Policisë Durrës

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Durrës:
-arrestuan në flagrancë shtetasin J. L., 22 vjeç, banues në Durrës, pasi dyshohet se ka goditur me grushte babanë e tij, për motive të dobëta;
-ndaluan shtetasin në kërkim D. T. alias D. M., 44 vjeç, banues në Sukth, pasi në vitin 2020, Gjykata e Durrësit ka njëvsuar vendimin e autoriteteve gjyqësore italiane, që i kanë caktuar këtij shtetasi, masën e sigurisë "Arrest në burg", për veprën penale "Vjedhja" në rrethana rënduese.

Gjithashtu, referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasit:
-B. D., 40 vjeçe dhe një 17-vjeçare, të dyja banuese në Durrës, pasi janë konfliktuar fizikisht me njëra-tjetrën, për motive të dobëta;
-Y. T., 28 vjeç, banues në Durrës, pasi dyshohet se ushtronte aktivitetin e paligjshëm të lojërave të fatit, me celular, në ambientet e një lokali në lagjen nr. 13. Celulari u sekuestrua në cilësinë e provës materiale.
U zhvillë në kërkim shtetasi Xh. D., 20 vjeç, banues në Durrës, pasi dyshohet i ka marrë një automjet, një 32-vjeçari, duke e mashtruar, dhe nuk ia ka kthyer më. Punohet për kapjen e shtetasit Xh. D. dhe për gjetjen e automjetit.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Stacionit të Policisë Plazh referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasit:
-F. D., 62 vjeç dhe A. M., 59 vjeç, të dy banues në Durrës, pasi janë konstatuar duke kryer punime ndërtimi në lagjen nr. 13, pa leje nga organet kompetente;
-A. Z., 33 vjeç, banues në Durrës, pasi dyshohet se ka kryer punime ndërtimi, pa leje nga organet kompetente.
Gjithashtu, referuan materialet në Prokurori dhe shpallën në kërkim shtetasin G. B., 31 vjeç, banues në Durrës, pasi ka kallëzuar shtetasi G. Ç., se 31-vjeçari i ka pushtuar tokën e tij, i ka shkatërruar dhe i ka marrë portën që kishte vënë në këtë pronë. Punohet për kapjen e 31-vjeçarit dhe për dokumentimin e rrethanave të rastit.

-Dje, rreth orës 16:50, është dërguar në Spitalin Rajonal Durrës, shtetasi B. T., 69 vjeç, i cili dyshohet se aksidentalisht është rëzuar nga shkallët e banesës dhe si pasojë është dëmtuar. Ai u dërgua për trajtim mjekësor të specializuar, në Spitalin e Traumës.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Durrësit, për veprime të mëtejshme.

Tiranë/Vijon operacioni i koduar "Catch", si rezultat i punës operative dhe kontrolleve, për kapjen e shtetasve në kërkim.

✅Të dënuar me mbi 6 vjet e gjysmë burgim, për krime në fushën e narkotikëve, lokalizohen dhe kapen 2 shtetas.

✅Kapet dhe 1 shtetas i akuzuar për vjedhje me pasoja të rëndа.

Gjatë kësaj faze të operacionit të koduar "Catch", shërbimet në varësi të Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë lokalizuan dhe ndaluan 3 shtetas të tjerë të shpallur në kërkim, konkretisht:

-specialistët e Seksionit për Hetimin e Narkotikëve, në bashkëpunim me shërbimet e Forcës së Posaçme Operacionale, kapën shtetasin N. H., 41 vjeç, i cili është dënuar nga Gjykata e Tiranës, me 3 vjet e 4 muaj burgim, për veprën penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve";

-specialistët e Seksionit për Hetimin e Narkotikëve, në bashkëpunim me shërbimet e Komisariatit të Policisë Rinas, kapën shtetasin J. Ç., 38 vjeç, i cili është dënuar nga Gjykata e Tiranës, me 3 vjet e 4 muaj burgim, për veprën penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikeve". Nga ky dënim, 38-vjeçari i kanë mbetur për të vuajtur 2 vjet burgim;

-shërbimet e Komisariatit të Policisë Nr. 2 kapën shtetasin B. M., 43 vjeç, për të cilin Prokuroria ka nxjerrë urdhër ndalimi, për veprën penale "Vjedhja", me pasoja të rëndа.

Kontrollet dhe puna operative vijojnë.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Tiranës, për veprime të mëtejshme.

Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan

Specialistët për Hetimin e Narkotikëve kapën dhe vunë në pranga shtetasin e shpallur në kërkim, I. F., 45 vjeç, banues në Elbasan, pasi Gjykata e Elbasanit i ka caktuar masën e sigurisë "Arrest në burg", për veprën penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve".

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Elbasan:
-kryen veprimet për arrestimin në flagrancë të shtetasit Xh. A., 27 vjeç (me probleme të shëndetit mendor), pasi dyshohet se ka kanosur me mjet prereës (thikë) dhe ka dhunuar, 2 familjarë të tij, si dhe se ka dëmtuar derën e banesës së njërit prej tyre;

-referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetaset E. R. dhe Xh. T., me detyrë mjeke në Urgjencën e spitalit të Elbasanit, pasi ka kallëzuar shtetasja E. T., se ka humbur ëtën në këtë qavion, rënia e saj, shtetasja L. Gj.

Kërko

Enter a word for search

Komisariati Dixhital

GET IT ON Google Play

Download on the App Store

Arkiva

Select Month

Linqe

- Arkiva
- Akademia e Sigurisë
- Ministria e Brendshme
- Agjencia e Mbikëqyrjes Policore
- Interpol
- Europol
- Misioni PAMECA V
- SCPA
- Projekti Trivalent